

BANKË ME NJËSI TESTESH

PROFILI:

RRJETE TË DHËNASH

LËNDA:

“Rrjete kompjuterike”, klasa 12-të

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. Duhet të lidheni në një router që ka adresën IP 192.168.1.100 të klasës C me subnet mask 255.255.255.0. Cila nga adresat IP të mëposhtme është e vlefshme për pajisjen e rrjetit?

(1 pikë)

- A) 192.168.0.1
- B) 192.168.1.1
- C) 192.168.100.1
- D) 192.168.1.100

Përgjigje: B

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sapo keni instaluar një paisje rrjeti dhe keni konfiguruar adresën IP dhe subnet mask. Cilën nga komandat e mëposhtme do të përdornit për të vërtetuar se adresa është konfiguruar saktë?

(1 pikë)

- A) Ping
- B) Tracert
- C) CMD
- D) Ipconfig

Përgjigje: A

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili protokoll përdoret nga një kompjuter për të gjetur MAC adresën e default gateway, në një rrjet Ethernet?

(1 pikë)

- A) ARP
- B) TCP
- C) UDP
- D) DHCP

Përgjigje: A

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Duhet të lidhni një kompjuter tek një grup hostesh të segmentuar nga rrjeti i rregullt. Çfarë lloj rrjeti është ky?

(1 pikë)

- A) LAN
- B) WLAN
- C) WAN
- D) VLAN

Përgjigje: D

5. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sa shtresa ka subnetwork-u i modelit të komunikimit OSI?

(1 pikë)

- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) 7

Përgjigje: D

6. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në cilën shtresë të modelit OSI-it qëndron një router që siguron aksesin në internet të një rrjeti?

(1 pikë)

- A) Physical
- B) Data link
- C) Network
- D) Transport

Përgjigje: C

7. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili mjet komunikimi lejon bashkëpunim në kohë reale?

(1 pikë)

- A) wiki
- B) e-mail
- C) weblog
- D) instant messaging

Përgjigje: D

8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Drejtori ju jep të drejtë për të hyrë në kompjuterin e tij, cilën komandë duhet të shkruajmë në **command prompt** për të gjetur MAC adresën?

(1 pikë)

- A) ipconfig
- B) ipconfig/all
- C) arp
- D) netstat -an

Përgjigje: B

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Çfarë lloj kablli duhet përdorur për të lidhur dy laptopë së bashku?

(1 pikë)

- A) Rolled cable
- B) Crossover cable
- C) Straight through cable
- D) Patch cable

Përgjigje: B

10. Rrethoni përgjigjen e saktë. Çfarë lloj topologjie është përdorur në figurën e mëposhtme?



(1 pikë)

- A) Bus
- B) Star
- C) Mesh
- D) Ring

Përgjigje: C

11. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila adresë në kompjuter nuk ndryshon, edhe nëse kompjuteri ndryshon lidhjen në rrjet?

(1 pikë)

- A) IP address
- B) default gateway address
- C) MAC address
- D) logical address

Përgjigje: C

12. Rrethoni përgjigjen e saktë. Rrjeti ka 10 kompjutera të lidhur së bashku me topologji yll (star). Cili nga të mëposhtmit mund të jetë një faktor dështimi dhe rënie e rrjetit?

(1 pikë)

- A) Cable
- B) Network card
- C) T-Connector
- D) Hub

Përgjigje: D

13. Rrethoni përgjigjen e saktë. Duhet të lidhim 100 kompjutera në një klasë adresash private. Cila nga adresat IP të mëposhtme plotëson kriterin e kërkuar?

(1 pikë)

- A) 100.10.1.0
- B) 192.168.1.0
- C) 172.16.0.0
- D) 10.0.0.0

Përgjigje: D

14. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një kompani ka zyrat qendrore dhe degët e saja. Të gjitha degët e aksesojnë internetin përmes kompanisë. Çfarë lloji rout-imi duhet aktivizuar për këtë lloj komunikimi?

(1 pikë)

- A) Asnjë
- B) Dinamik
- C) Statik
- D) Classless

Përgjigje: C

15. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një përdoruesi i është dhënë adresa fe80::9c5f:9695:f235:0051. Çfarë lloj adrese ka ky përdorues?

(1 pikë)

- A) IPv4 address
- B) IPv6 address
- C) MAC address
- D) GUID

Përgjigje: B

16. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cilin lloj DSL-je duhet të përdorim në mënyrë që informacioni i ngarkuar dhe ai i shkarkuar të kenë të njëjtën vlerë?

(1 pikë)

- A) xDSL
- B) ADSL
- C) SDSL
- D) DSL Lite

Përgjigje: C

17. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cilët nga protokollet e mëposhtme bën pjesë tek protokollet e email-it?

(2 pikë)

- A) POP3
- B) SMNP
- C) IMAP4
- D) Telnet

Përgjigje: A dhe C

18. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cili nga pohimet e mëposhtme përshkruan karakteristikat e kabllimit me fiber optike?

(2 pikë)

- A) Kabllimi me fibër optike nuk përçon elektricitet.
- B) Kabllimi me fibër optike ka humbje të mëdha sinjali.
- C) Kabllimi me fibër optike përdoret kryesisht në lidhjet backbone.
- D) Kabllimi Multimode me fibër optike mbart sinjalin nga shumë paisje dërguese.

Përgjigje: A dhe C

20. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cilat nga alternativat e mëposhtme janë funksione primare të një router-i?

(2 pikë)

- A) Switch-imi i paketave
- B) Mikrosegmentimi
- C) Rezolucioni i emrit të domein-it
- D) Zgjedhja e rrugës (path selection)

Përgjigje: B dhe D

21. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cili nga komponentet e mëposhtme është i domosdoshëm për një klient wireless që të instalohet në një WLAN?

(2 pikë)

- A) media
- B) wireless NIC (kartë wireless)
- C) kabull crossover
- D) një urë wireless

Përgjigje: B dhe D

22. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cili është përfitimi i përdorimit të një modeli rrjeti me shtresa?

(2 pikë)

- A) ndihmon në dizenjimin e protokolleve
- B) rrit shpejtësinë e shërndarjes së paketave
- C) ndalon dizenjuesit të ndërtojnë modelet e tyre
- D) ndalon teknologjinë e njërës shtresë të ndikojë tek shtresa tjetër

Përgjigje: A dhe D

23. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cilat nga komandat e mëposhtme mund të përdoren në një host Windows për të shfaqur tabelën e rout-imit?

(2 pikë)

- A) netstat -s
- B) route print
- C) show ip route
- D) netstat -r

Përgjigje: B dhe D

24. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cili nga mjetet e përdorura në rrjete ofrojnë minimumin e sigurisë së kërkuar për përdoruesit familjar?

(2 pikë)

- A) një sistem parandalimi virusesh
- B) një program antivirus me network protection
- C) lista e kontrollit të aksesit
- D) një firewall

Përgjigje: B dhe C

25. Shpjegoni dy veprimeve që kryhen nga switch-et CISCO:

(2 pikë)

Përgjigje:

1. Përdorimi i burimit të MAC adresave të freime-ve dhe mbajtja e një tabele të MAC adresave.
2. Përdorimi i tabelës së MAC adresës për të ridrejtuar freim-et përmes MAC adresës destinacion.

26. Cili është funksioni i shtresës së aplikacionit në suitën e protokolleve TCP/IP. Listoni dy prej protokolleve të kësaj shtrese?

(4 pikë)

Përgjigje: Shtresa e aplikacionit ofron shërbime të ndryshme si posta elektronike, transferimi i dosjeve në internet, shërbimin e rrjetit për përdoruesit fundorë, merret me gabimet në transmetim dhe zgjidhjen e tyre, etj. Përdoret gjithashtu për zhvillimin e aplikacioneve network-based.

Disa nga protokollet janë:

1. DHCP
2. DNS
3. FTP
4. HTTP
5. POP
6. IMAP
7. SMTP

27. Cilat shtresat të modelit OSI kanë të njëjtin funksion me shtresat e modelit TCP/IP?

(2 pikë)

Përgjigje:

Shtresat e **network-ut** dhe e **transportit** kanë të njëjtin funksion si në modelin OSI dhe atë TCP/IP.

28. Si e identifikon Switch-i, portën destinacion ku duhet të dërgohet paketa e të dhënave?

(2 pikë)

Përgjigje:

Switch-et krijojnë dhe ruajnë në memorien e tyre një tabelë të adresave MAC me anë të së cilës identifikon kompjuterat e lidhur në të, duke kombinuar numrin e portës me adresën fizike.

29. Listoni protokollat që veprojnë në shtresën e internetit në modelin TCP/IP dhe funksionet përkatëse:

(4 pikë)

Përgjigje:

Shtresa e internetit e modelit TCP/IP ka dy protokolle: IP dhe **ICMP**

1. **Protokolli IP - Internet Protocol** është një identifikues që i caktohet çdo kompjuteri apo pajisje që lidhet në një rrjet për lokalizimin dhe identifikimin e nyjes në komunikim.
2. **Protokolli ICMP - Internet Control Message Protocol** është protokoll mbështetës që përdoret nga paisjet e rrjetit për gjetjen e gabimeve në rrjet.

30. Plotësoni vendin bosh me fjalën që mungon.

_____ është një mekanizëm që përdoret për të identifikuar një rrjet wireless.

(1 pikë)

Përgjigje: SSID (Service Set Identifier)

31. Plotësoni vendin bosh me fjalën që mungon.

Nga tri protokollat e kodimit të rrjetit wireless, protokoll _____ është më pak i sigurti.

(1 pikë)

Përgjigje: WEP

32. Plotësoni vendin bosh me fjalën që mungon.

Nëse ju duhet të shpërndani një linjë interneti ose të lidheni në një rrjet kabllor përmes rrjetit tuaj wireless, do të përdornit _____.

(1 pikë)

Përgjigje: Router

33. Plotësoni vendin bosh me fjalën që mungon.

Koha që i duhet një pakete të udhëtojë drejtë destinacionit dhe të kthehet quhet _____.

(1 pikë)

Përgjigje: Ping

34. Shpjegoni cila është topologjia më tolerante ndaj gabimeve dhe pse?

(3 pikë)

Përgjigje:

Topologjia **mesh** është më tolerantja ndaj gabimeve, pasi përdor lidhje të shumëfishtë me rrjetin. Në këtë topologji çdo kompjuter është i lidhur me të gjithë kompjuterat e tjerë.

35. Shpjegoni ku ndryshon switch-i i shtresës së 3-të nga ai i shtresës së 2-të?

(2 pikë)

Përgjigje:

Në portat fizike të switch-it të shtresës së tretë mund të caktohen adresa IP. Ndërsa në switch-et e shtresës së dytë kjo nuk është e mundur.

36. Cili është qëllimi i procesit të routimit?

(2 pikë)

Përgjigje:

Të përzgjedhë rrugët (path) që do përdoren për të drejtuar trafikun e komunikimit për në rrjetet e destinuara.

37. Shpjegoni cili është ndryshimi mes ADSL dhe SDSL?

(4 pikë)

Përgjigje:

Ndryshimi mes ADSL dhe SDSL është se për rrjetin e shtëpive dhe bizneseve të vogla përdoret ADSL, ndërsa kompanitë e mëdha përdorin SDSL, për faktin se ka shpejtësi të madhe shkarkimi dhe ngarkimi.

SDSL vepron me vlera afërsisht 2 deri në 2.5Mbps si për shkarkim dhe për ngarkim ndërsa ADSL gjeneron shpejtësi shkarkimi afërsisht nga 640 Kbps deri në 8Mbps.

38. Cilët janë dy tiparet e protokollit ARP?

(2 pikë)

Përgjigje:

1. Nëse një host është gati të dërgojë paketa në një destinacion lokal por ka vetëm adresën IP dhe nuk ka MAC adresën e destinacionit, ai gjeneron një ARP të cilës i bën broadcast, pra e shpërndan në të gjitha drejtimet.
2. Nëse një pajisje që po merr një kërkesë ARP ka adresë IP destinacion, ajo kthen përgjigjen ARP.

39. Një administrator po përpiqet të konfigurojë switch-in, por merr mesazhin e gabimit siç tregohet më poshtë. Cili është problemi dhe zgjidhja e tij?

```
Switch1> config t
^
% Invalid input detected at '^' marker.
```

(2 pikë)

Përgjigje: Procesi nuk ka filluar nga **config mode**.

Në fillim administrator duhet të vendosi mënyrën e privilegjuar EXEC, pastaj të ekzekutojë komandat.

40. Shpjegoni kuptimin e termave të mëposhtëm:

(6 pikë)

ISP _____

_____ **E-Mail**

HTML _____

_____ **Përgjigje:**

- **ISP** - *Internet Service Provider*. Një ISP është një kompani që siguron linjën e internetit për klientët e saj, pavarësisht nëse ata janë përdorues familiar apo biznese.
- **E-mail** - *Electronic Mail*. Mënyra e dërgimit të mesazheve duke përfshirë tekst, grafikë, audio dhe dokumente të ekzekutueshme përmes internetit apo intranetit. Mesazhi ka një dërgues dhe një ose më shumë marrës.
- **HTML** - *Hypertext Markup Language*. HTML është gjuha më e përdorur për ndërtimin e faqeve web. Dosjet HTML përfshijnë aftësinë për të "lidhur" në një dokument vendndodhje të ndryshme, qofshin këto dosje të ndryshme apo faqe të ndryshme në internet.

41. Jepni shpjegimet përkatëse për protokollat e mëposhtme:

(6 pikë)

IPX/SPX _____

_____ **FTP**

HTTP

Përgjigje:

- **IPX/SPX** - *Internetwork Packet Exchange/Sequenced Packet Exchange*. Është një protokoll rrjeti i përdorur në rrjetet Novell (Netware). Është një protokoll rout-imi i cili përdoret si në rrjetet e vogla dhe në ato të mëdha. Punon në shtresën e network-ut.
 - **FTP** - *File Transfer Protocol*. Është një protokoll që përdoret për transferimin e dosjeve nga një kompjuter tek një tjetër, zakonisht përmes internetit duke përdorur modelin klient-server.
 - **HTTP** - *Hypertext Transfer Protocol*. Është një protokoll që përdoret për shpërndarjen e faqeve web në internet. Përdoret përmes një web browser duke bërë lidhjen mes web server-it dhe klientit web. Përdoruesi shkruan një URL (Uniform Resource Locator) ose një emër domain-i në browser dhe përmes komunikimit me DNS-në përkthehet në adresë IP duke na dhënë rezolucionin e emrit dhe materialin e kërkuar.
42. Kompania A ka një rrjet që funksionon vetëm brënda ndërtesës. Kjo kompani blihet nga një tjetër kompani B me seli në shtet tjetër dhe kërkon të shkëmbejë të dhënat. Kompania B ka një rrjet të ngjashëm të përbërë nga disa servera dhe kompjutera, ku secili kompjuter lidhet në një hub të vetëm. Ndërsa kompjuterat klientë të kompanisë A janë pa kablllo dhe serverat lidhen në grup tek hub-et. Bazuar në këtë informacion, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:
- (5 pikë)
1. Përse përdoret rrjeti WAN, dhe si mund të aplikohet në këtë rast?
- (2 pikë)
-
-
-
2. Çfarë topologjie përdor firma B?
- (1 pikë)
-
3. Çfarë topologjie përdor firma A?
- (1 pikë)
-
4. Cilët komponente në të dy rrjetet kanë më shumë probabilitet të dështojnë?
- (1 pikë)
-

Përgjigje:

1. Një WAN lejon një kompani të lidhet me degët e saja pavarësisht pozicioneve gjeografike sikur të jetë një pjesë e vetme, dhe të funksionojë si segmente të një LAN-i. Në këtë rast mund të aplikohet përmes **përdorimit** të një lidhjeje me shpejtësi të lartë mes dy zyrave.
2. Firma B përdor topologjië yll (star).
3. Firma A përdor një topologji wireless.
4. Kabllot.

42. Jepni **tri** përkufizime që përdoren zakonisht për të përcaktuar **Rrjetin**:

(3 pikë)

Përgjigje:

1. **Rrjet** quhet dy ose më shumë kompjutera të lidhur së bashku të cilët shkëmbejnë informacion, paisje etj.
 2. **Rrjet** kemi atëherë kur dy ose më shumë rrjete janë të lidhur së bashku, siç është rasti i Internetit.
 3. **Një rrjet** është një sistem topologjish, protokollesh dhe përbërësish aktivë që krijojnë, organizojnë dhe mbajnë komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave.
43. Duhet të krijojmë një rrjet në një shtëpi, ku përdoren një kompjuter Apple iMac dhe një tjetër Windows 7. Të dy disponojnë karta rrjeti të instaluar. Duam që kompjuterat të lidhen së bashku por nuk mund të blejmë pajisje të tjera për rrjetin. Çfarë lloj rrjeti mund të krijojmë dhe pse? Jepni shpjegimin përkatës?

(4 pikë)

Përgjigje:

Peer-to-peer. Një rrjet peer-to-peer është më i thejshti dhe më pak i kushtueshmi nga të gjithë modelet e tjera. Nuk ka nevojë për një server dhe mund të krijohet duke përdorur

një paisje mjaft të lirë si Hub-i që kushton më lirë se switch-i. Duke qënë se kompjuterat janë të një familjeje, nuk ka as problem me sigurinë, ndaj rrjeti P2P është më se i përshtatshëm.

44. Në një rrjet asnjë post pune nuk po komunikon dot me tjerët. Ata përdorin kabull koaksial thin-line. Cili mund të jetë problem dhe si veprim për zgjidhjen e tij?

(3 pikë)

_____ **Përgjigje**

Lidhja backbone duhet të jetë ndërprerë në mënyrë të dhunshme ose jo saktë. Duhet gjetur pika ku topologjia BUS është ndërprerë, të rilidhet dhe të sigurohet që rrjeti backbone do përfundojë në mënyrë të saktë.

45. A është fibra optike media më e mirë për të implementuar një rrjet të zakonshëm të një zyre? Jepni shpjegimin tuaj:

(3 pikë)

_____ **Përgjigje:**

Zakonisht, për shkak të kostove të limituara, zyrat lidhen me kabullo UTP dhe STP dhe data center lidhet me fiber. Fibra gjithashtu përdoret për lidhjet backbone ndërmjet ndërtesave. Kjo është mënyra më e mirë dhe që justifikon koston dhe mundëson shpejtësi komunikimi.

46. Çfarë të përbashkëtash dhe ndryshimesh ka mes ISDN dhe dial-up?

(3 pikë)

_____ **Përgjigje**

Të dyja përdorin sinjalin telefonik, por dial-up është e bazuar në sistemin e telefonisë dhe përdor sinjal analog, ndërsa ISDN përdor sinjalin digjital.

47. Cilat lloje rrjetesh përdorin OSPF në vend të RIP? Argumentoni përgjigjen tuaj:

(3 pikë)

Përgjigje:

OSPF përdoret nga rrjeta të mëdha kompanish, nga rrjeti i internetit i kampuseve apo rrjeta globale. Zakonisht Microsoft-i rekomandon përdorimin e OSPF-së për rrjete që përfshijnë mbi 50 rrjete të lidhura së bashku. OSPF është i përshtatshëm edhe për rrjetet ku topologjia ndryshon vazhdimisht.

48. Cilët janë dy kriteret që përdoren për të zgjedhur llojin e medias së komunikimit (Kablli)?

(2 pikë)

Përgjigje:

Dynga kriteret që përcaktojnë llojin e medias që duhet përdorur janë:

1. distanca maksimale që një media mund të transmetojë të dhënat dhe
2. mjedisi ku duhet instaluar kjo media.

49. Cilat janë dy **avantazhet** në përdorimin e rout-imit **statik** ndaj atij **dinamik**?

(2 pikë)

Përgjigje:

Në rout-imin statik ndryshe nga ai dinamik ka:

1. përmirësim të sigurisë në rrjet duke përdorur rrugë të njohura transmetimi dhe
2. përdoren më pak gjerësi bande të rrjetit dhe më pak veprime në CPU.

50. Një administrator rrjeti po konfiguronte një switch të ri Cisco për menaxhim në distance. Çfarë komandash duhet të konfigurujë ai në switch që të kryhet kjo detyrë?

(3 pikë)

Përgjigje:

Që të realizojmë menaxhimin në distance për një switch Cisco duhet konfiguruar **adresa IP, default VLAN dhe adresa loopback**.

51. Një kompani do të sigurojë rrjetin e saj LAN. Kompania kërkon një pajisje që të shfaqë një adresë IP publike në internet, gjithashtu të lejojë klientët lokal me IP private në LAN të komunikojnë në internet. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

(3 pikë)

1. Çfarë lloj pajisje po kërkon kompania? Argumentoni përgjigjen:

(2 pikë)

2. Çfarë teknologjie rrjeti duhet implementuar në atë pajisje?

(1 pikë)

Përgjigje:

1. Pajisja për t'u instaluar mund të jetë një router, një server apo çdo pajisje e ngjashme, mjafton që të ketë dy karta rrjeti. Njëra kartë duhet për rrjetin LAN dhe tjetra për rrjetin WAN.
2. Teknologjia e përdorur është NAT- Network Address Translation.

BANKË ME NJËSI TESTESH

PROFILI:

LËNDA:


RRJETE TË DHËNASH

“Algoritmike dhe programim”, klasa 12-të

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. Bllokskema e mëposhtme konsiderohet jo korrekte për arsye se:

(1 pikë)

- A) ka më shumë se një simbol fillimi
- B) ka më shumë se një simbol fundor
- C) duhet të ketë 6 simbole fundorë
- D) ka vetëm tre simbole fundorë



Përgjigje: B

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Format i ciklit **for** është:

(1 pikë)

- A) for ()
- B) for {}
- C) for (inicializim;konditë;shtim) statement;
- D) for (inicializim:konditë:shtim) stetement

Përgjigje: C

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Funksionaliteti i instruksionit **if** është:

(1 pikë)

- A) të vlerësojë një konditë
- B) të vlerësojë një statement
- C) të vlerësojë konditën dhe të ekzekutojë satementin
- D) të vlerësojë konditën dhe të injorojë statementin

Përgjigje: C

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Operatorët logjikë janë:

(1 pikë)

- A) and, not, or

- B) and, or
- C) not , or
- D) and, not

Përgjigje: A

5. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në operatorët e krahasimit nuk përfshihet:

(1 pikë)

- A) >
- B) <
- C) ==
- D) %

Përgjigje: D

6. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në operatorët aritmetikë përfshihen:

(1 pikë)

- A) %, +, ÷
- B) %, +, -, ÷
- C) %, +, -, ÷, ×
- D) %, +, ÷, ×

Përgjigje: C

7. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një bllokskemë konsiderohet korrekte kur ka:


(1 pikë)

- A) një fillim dhe një mbarim
- B) një hyrje dhe një dalje
- C) një hyrje dhe një mbarim
- D) një fillim dhe një dalje

Përgjigje: A

8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në lidhje me vijat e rrjedhjes, bllokskema e mëposhtme konsiderohet jo korrekte për arsye të:

(1 pikë)



- A) përdorimit të një simboli lidhës për të lidhur vijat e rrjedhjes logjike
- B) dy vijave të rrjedhës llogjike që paraqiten dydrejtimëshe
- C) mospërdorimit të një simboli lidhës për lidhjen e dy vijave
- D) përdorimit të simbolit të procesit fundor

Përgjigje: C

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një simbol hyrje/dalje, mund të vizualizojë hyrjen nga një _____ në një bllokskemë.

(1 pikë)

- A) paisje rezervimi
- B) tastjerë
- C) monitor elektronik
- D) modem

Përgjigje: B

10. Rrethoni përgjigjen e saktë. Funksionaliteti i ciklit while është të përsërisë statementin derisa kondita të jetë e vërtetë.

(1 pikë)


PO

JO

Përgjigje: PO

11. A është e saktë bllokskema e mëposhtme?

(1 pikë)



PO

JO

Përgjigje: JO

12. Plotësoni vendet bosh me fjalët e duhura:

1. Zgjidhja e problemeve nëpërmjet simboleve terminale quhet _____.
2. Radha e instruksioneve për zgjidhjen e një problemi të paraqitur me fjalë quhet _____.
3. Një varg instruksionesh që zgjidh një problem quhet _____.


(3 pikë)


Përgjigje:

1. bllokskemë
2. pseudokod
3. algoritëm

13. Konvertoni bllokskemën e llogaritjes së sipërfaqes në pseudokod:

(5 pikë)






Përgjigje:

Pseudokodi:

- fillim
- vendosen në kompjuter të dhënat hyrëse, që janë gjerësia dhe gjatësia e ambientit
- llogaritet sipërfaqja duke shumëzuar gjerësinë dhe gjatësinë
- afishohet sipërfaqja
- fund

14. Bashkoni me shigjetë simbolet që renditen në krahun e majtë (shënuar me shkronja), me konceptin përkatës në të djathtë (shënuar me numra):

(3 pikë)



1. Hapat ku kryhen llogaritjet

2. Vija të rrjedhës së algoritmit



3. Lidhësi i dy pjesëve të një programi

4. Marrja e vendimit dhe degëzimi



5. Veprimi i hyrjes dhe daljes

6. Fillimi ose mbarimi i programit

Përgjigje:

a) - 4; b) - 5; c) - 3;

15. Tregoni cilat janë rezultatet që afishohen në ekran në programin e mëposhtëm?

```

#include <iostream>
using namespace std;
int main() {
    int x = 3, y = 6, z = 10;
    cout << "3 * 6 is " << x * y << endl
         << "10 % 3 is " << z % x << endl
         << "10 / 3 is " << (float) z / x << endl;
}
  
```

(3 pikë)

Përgjigje:

```
3 * 6 is 18
10 % 3 is 1
10 / 3 is 3.3
```

16. Vlerësoni shprehjet e mëposhtme me V (e vërtetë) dhe G (e gabuar). Supozojmë se $a = 5$, $b = 2$, $c = 4$, $d = 6$ dhe $e = 3$:

(5 pikë)

1. $a > b$
2. $a != b$
3. $d \% b == c \% b$
4. $a * c != d * b$
5. $d * b = c * e$

Përgjigje:

1 - V; 2 - V; 3 - G; 4 - V; 5 - V

17. Vlerësoni shprehjet e mëposhtme me V (e vërtetë) dhe G (e gabuar).

1. $(7 == 5)$ ____
2. $(5 > 4)$ ____
3. $(3! = 2)$ ____
4. $(6 = 6)$ ____
5. $(5 < 5)$ ____

(5 pikë)

Përgjigje:

1 - G; 2 - V; 3 - V; 4 - V; 5 - G

18. Përcaktoni rezultatin e programit që do të afishohet pas ekzekutimi :

(2 pikë)

```
#include <iostream>
using namespace std;
int main()
{
    cout << " mbetja e pjesëtimit të 9 pjesëtuar me 4 është : " << 9%4
    << "\n mbetja e pjesëtimit të 17 pjesëtuar me 3 është : "
    << 17%3 << endl;
    return 0;
}
```

Përgjigje:

Veprimet që kryhen me operatorin modular janë:

$9\%4 = 2$ (mbetja 1)

$17\%3 = 5$ (mbetja 2)

1. mbetja e pjesëtimit të 9 pjesëtuar me 4 është: 1
2. mbetja e pjesëtimit të 17 pjesëtuar me 3 është: 2

19. Paraqisni me kod burimi, dekrementimin e ciklit for në C++ për : $n=10$?

(3 pikë)

```
// numurimit zbritës duke përdorur ciklin for
#include <iostream>
using namespace std;
```

```
int main ()

    cout << "Nisu!\n";
    return 0;
}
```

Përgjigje:

```
// numurimit zbritës duke përdorur ciklin for
#include <iostream>
using namespace std;
int main ()
{
    for (int n=10; n>0; n--) {
        cout << n << ", ";
    }
    cout << "Nisu!\n";
    return 0;
}
```

20. Dedektoni gabimet në kodin e dhënë dhe bëni korrigjimin e tyre:

(3 pikë)

```
// vlerësimi i nxënësve
#include <iostream>
using namespace std;

int main
{
    int test1, test2, test3, shuma = 0

    cout << "Fusni pikët e tri testeve\n";
    cin >> test1 >> test2 >> test3;
    shuma = test1 + test2 + test3;
    if(shuma > 50)
        cout << "nxënësi është kalues\n"

    return 0
}
```

Përgjigje:

```
// vlerësimi i nxënësve
#include <iostream>
using namespace std;

int main ()
{
    int test1, test2, test3, shuma = 0;

    cout << "Fusni pikët e tre testeve\n";
    cin >> test1 >> test2 >> test3;
    shuma = test1 + test2 + test3;
    if(shuma > 50)
        cout << "nxënësi është kalues\n";
}
```

```
return 0;
}
```

21. Të llogaritet shuma e dy numrave të plotë duke përdorur një funksion me kod burimi në C++?

(7 pikë)

Përgjigje:

Në këtë ushtim nxënësi duhet të gjejë shumën e dy numrave që janë:

- **Numri i parë është a**
- **Numri i dytë është b**
- **Më pas do të deklaroj shumën si funksion**
- **Do të thërrasë komponentët në main**
- **Dhe në fund do të përcaktojë funksionin shuma**

```
//ky program gjen shumën e dy numrave duke thirrur një
//funksion, shih deklarinimin dhe përcaktimin e funksionit
#include <iostream>
using namespace std;
//deklarimi i funksionit shuma()
int shuma(int, int);
int main ()
{
    int a=1, b=2, rezultat;

    rezultat= shuma(a,b);
    cout<< "shuma e a, b: " << rezultat << endl;
    return 0;
}
//përcaktimi i funksionit shuma()
int shuma(int a, int b)
{
    int s;
    s=a+b;
    return (s);
}
```

22. Konvertoni fillimin dhe mbarimin e kodit në C++ në bllokskemën e mëposhtme?

```
int main () // fillimi i programit
```


```

{
    return 0; //fundi i programit
}

```

(2 pikë)

Përgjigje:



23. Tregoni çfarë afishohet nga cout-i më poshtë:

```

cout << "një shprehje në ekran";
cout << 120;
cout << x;

```

(3 pikë)

Përgjigje:

```

// printon një shprehje në ekran
// printon numrin 120
// printon përmbajtjen e x-it

```

24. Përcaktoni vlerat që do të printohen nga cikli i mëposhtëm:

```

For (int i =0; i<=15; i+=5 )

```

(4 pikë)

Përgjigje:

Indentifikuesi i variablit i=0

I+=5 është ekuivalente me i=i+5

Pra vlerat në këtë instruksion do të rriten me 5

Vlerat që printohen janë: 0, 5, 10, 15

25. Përkufizoni funksionalitetin e ciklit **do while**:

(3 pikë)

Përgjigje:

Funksionaliteti i ciklit do while është të përsërisë statementin derisa kondita të jetë e vërtetë por në diferencë me ciklet e tjera. Ky cikël statementi ekzekutohet para se kondita të vlerësohet kështu që edhe nëse kondita plotësohet ose nuk plotësohet një statement sigurohet.

26. Përcaktoni formatin e ciklit **while**?

(1 pikë)

Përgjigje:

Formati i tij është:

while (kondita) statement

27. Tregoni çfarë afishohet nga kodi i mëposhtme nëse n=8:

```
// numurim zbritës duke përdorur while
```

```
#include <iostream>
using namespace std;
```

```
int main ()
{
    int n;
    cout << "Filloni me numrin > ";
    cin >> n;
```

```
    while (n>0) {
        cout << n << ", ";
        --n;
    }
```

```
    cout << "Nisu!\n";
    return 0;
}
```

(3 pikë)

Përgjigje:

Filloni me numrin 8
8, 7, 6, 5, 4, 3, 2, 1, Nisu!

28. Plotësoni instruksionet që mungojnë në kodin e mëposhtëm:

(3 pikë)

```
#Include <iostream>
Using namespace std;
Int main ()
{

Cin>> a;
Cin>>b;
Cout <<" gjeni shumën";
Shuma = a+b;
Cout <<"      ":

    <<endl;
Return 0;
}
```

Përgjigje:

```
#Include <iostream>
Using namespace std;
Int main ()
{
Int a, b, shuma;
Cin>> a;
Cin>>b;
Cout <<" gjeni shumën";
Shuma = a+b;
Cout <<"shuma":
    <<shuma
    <<endl;
Return 0;
}
```

29. Përcaktoni sa janë vlerat për indentifikuesit e variablit **a** dhe **b** në kodin mëposhtë:

```
#include <iostream>
using namespace std;

int main ()
{
    int a, b;
    a = 10;
```

```
b = 4;
a = b;
b = 7;
cout << "a:";
cout << a;
cout << " b:";
cout << b;
return 0;
}
```

(2 pikë)

Përgjigje:

a: 4 dhe b: 7

30. Konvertoni pseudokodin e mëposhtme në kod burimi në C++:

Emri juaj? Arjan Bregu

Përshëndetje Arjan Bregu

Dega juaj? Informatikë Ekonomike

Më pëlqen Informatikë

Ekonomike shumë!

(6 pikë)

Përgjigje:


```
#include <iostream>
#include <string>
using namespace std;
int main ()
{
    string njëstr;
```

```

cout << "Emri juaj? ";
getline (cin, njëstr);
cout << "Përshëndetje " << njëstr << "!\n";
cout << "Dega juaj? ";
getline (cin, njestr);
cout << "Më pëlqen " << njëstr
    << " shumë!\n";
return 0;
}

```

31. Bllokskemën e mëposhtme konvertoheni në kod c++:



(3 pikë)

Përgjigje:

```

// program im i parë në C++
#include <iostream>
using namespace std;
int main ()
{
    cout<<"Programi im i parë në C++\n";

    return 0;
}

```

32. Rendisni operatorët e mëposhtme nga prioriteti më i madh në atë më të ulët:

Niveli	Operatori
1	= *= /= %= += -= >>= <<=
2	* / %
3	== !=
4	+ -

(4 pikë)

Niveli	Operatori

Përgjigje:

Niveli	Operatori
1	* / %
2	+ -
3	== !=
4	= *= /= %= += -= >>= <<=

33. Përcaktoni strukturën e konditës **if - else**:

(2 pikë)

Përgjigje:

Struktura e konditës **if** është:

```
if (konditë)
    statement
```

Struktura e konditës **else** është:

```
if (konditë)
    statement1
else
    statement2
```

34. Emërtoni operatorët e mëposhtëm të krahasimit:

(4 pikë)

1	==	
2	!=	
3	>=	
4	<=	

Përgjigje:

1	==	I barabartë me
2	!=	Jo i barabartë me
3	>=	Më i madh ose i barabartë me

4	<=	Më i vogël ose i barabartë me
---	----	-------------------------------

35. Përcaktoni ekuivalencën e operatorve të mëposhtëm:

1. `vlara += rritja;`
2. `a -= 5;`
3. `a /= b;`
4. `çmimi *= njësiti + 1;`

(4 pikë)

Përgjigje:

1. `vlara = vlara + rritja;`
2. `a = a - 5;`
3. `a = a / b;`
4. `çmimi = çmimi * (njësiti + 1);`

BANKË ME NJËSI TESTESH

PROFILI:

RRJETE TË DHËNASH

LËNDA:

“Administrim rrjetesh kompjuterike”, klasa 12-të dhe 13-të

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. Firma juaj ka një Active Directory forest që përmban një domain të vetëm. Pjesëtarët e domain-it kanë një rol Active Directory Federation Services (AD FS) të instaluar. Duhet të konfiguroni AD FS për t’u siguruar që opsionet e AD FS të përmbajnë informacion nga domain-i i Active Directory. Çfarë duhet të bëni?

(1 pikë)

- A) shtimin dhe konfigurimin e një llogarie të re partnere
- B) shtimin dhe konfigurimin e një burimi të ri partner
- C) shtimin dhe konfigurimin e një hapësire të re llogarie
- D) shtimin dhe konfigurimin e aplikacionit Claims-aware

Përgjigje: C

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Ju kërkohet të kontrolloni një server në distance nga brenda ndërfaqës GUI të klientit. Cili është mjeti më i përshtatshëm për t’u përdorur?

(1 pikë)

- A) Remote Desktop
- B) Telnet
- C) FTP
- D) SSH

Përgjigje: A

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Rrjeti juaj ka një domain Active Directory të quajtur test.com. Duhet të siguroheni se kur kompjuterat lidhen manualisht në domain përmes System Properties, llogaria e kompjuterit krijohet automatikisht tek njësia organizative (OU) të quajtur Kompjuteri i ri. Cilën komandë duhet të ekzekutoni?

(1 pikë)

- A) dsmgmt.exe
- B) redircmp.exe
- C) csvde.exe
- D) computerdefaults.exe

Përgjigje: B

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Rrjeti juaj ka një Active Directory forest. Struktura forest përmban një domain të vetëm të quajtur test.com. Domain-i përmban domain controllers që ekzekutojnë edhe Windows Server 2003 ose Windows Server 2008 R2. Niveli funksional i domain-it dhe i forest është Windows Server 2003. Duhet të shtoni një read-only domain controller (RODC) në forest. Çfarë duhet të bëni në fillim?

(1 pikë)

- A) të bëni upgrade domain controller-it që ekzekuton Windows Server 2003
- B) të rrisni nivelin funksional të domain-it

- C) të ekzekutoni komandën adprep
- D) të rrisni nivelin funksional të structures forest

Përgjigje: C

5. Rrethoni përgjigjen e saktë. Duhet të instaloni versionin e fundit të RIP në Windows Server 2008. Cilin version duhet të përzgjidhni?


(1 pikë)

- A) Version 1
- B) Version 2
- C) Version 3
- D) RIP nuk ka asnjë version

Përgjigje: B

6. Rrethoni përgjigjen e saktë. Çfarë lloj menaxhimi rrjeti tregohet në figurë?

(1 pikë)



- A) diagrama e rrjetit logjik
- B) diagrama e rrjetit fizik
- C) skema e kabllimit
- D) dokumentimi CM

Përgjigje: B

7. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila alternativë është më e sakta për serverin?

(1 pikë)

- A) një paisje e lidhur në rrjet që siguron rout-im të IP-së në rrjet
- B) një paisje e lidhur në rrjet që siguron shërbime në rrjet dhe pajisjet e këtij rrjeti
- C) një pajisje stand-alone që përdoret nga një përdorues për të bërë llogaritje matematikore
- D) një pajisje e lidhur në rrjet që përdoret për të aksesuar faqe web-i nga një web browser

Përgjigje: B

8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga tipet e pajisjeve kompjuterike të mëposhtme, përdor shërbimet e një rrjeti?

(1 pikë)

- A) Web Server
- B) DNS Server
- C) Client
- D) Ethernet cable

Përgjigje: C

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Keni instaluar një printer në një Windows Server 2008 R2 i cili mund të përdoret në rrjet. Përdoruesit me sistem operativ Windows 7 x86 Klient nuk mund të printojnë. Çfarë duhet të bëni?

(1 pikë)

- A) të shtoni një drajver 32-bit
- B) të shtoni një drajver 64-bit
- C) të ri-instaloni printerin
- D) të ri-instaloni sistemin operativ klient Windows 7

Përgjigje: A

10. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cilat të drejta NTFS lejojnë përdoruesit të shikojnë objektet në një skedar, por jo të lexojë përmbajtjen e tyre?

(1 pikë)

- A) lexo
- B) modifiko
- C) shkruaj
- D) listo përmbajtjen e skedarit

Përgjigje: D

11. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila është URL-ja e saktë e përdorur për aksesin në ndërfaqësinë e menaxhimit të printerit të bazuar në web në një Windows server të quajtur SRV5 që ka të instaluar dhe aktivizuar menaxhimin e bazuar në web?

(1 pikë)

- A) <http://printera>
- B) <http://SRV5/printera>
- C) <http://printera/SRV5>
- D) <http://SRV5>

Përgjigje: B

12. Rrethoni përgjigjen e saktë. Një përdorues duhet të printojë një detyrë shumë të rëndësishme. Ju doni të siguroheni se kjo detyrë do të printohet menjëherë sapo të mbarojë printimi në proces. Çfarë veprimi duhet të bëni në server?

(1 pikë)

- A) të ndaloni të gjitha printimet në radhë
- B) të fshini të gjitha kërkesat për printim
- C) të ristartoni të gjitha kërkesat e tjera për printim
- D) të ndryshoni prioritetet e printimit të ri

Përgjigje: D

13. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili komponent i “Forefront Threat Management Gateway” është përgjegjës për skanimin e trafikut të rrjetit për programe të dëmshme?

(1 pikë)

- A) sigurimi i e-mail-it
- B) zbulimi i programeve të dëmshme në web
- C) shërbimi i kontrollit të rrjetit

D) kontrolli i HTTPS

Përgjigje: C

14. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një detyrë fillestare konfigurimi?

(1 pikë)

A) konfigurimi i rrjetit

B) konfigurimi i datës dhe orës

C) caktimi i emrit të kompjuterit

D) shtimi i rolit të Adding the Active Directory Domain Services

Përgjigje: D

15. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili është protokoli i caktuar i komunikimit i përdorur mes mail server-ave Microsoft Outlook klient dhe Exchange Server?

(1 pikë)

A) POP3

B) SIP

C) MAPI

D) IMAP

Përgjigje: C

16. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili është hapi i parë në planifikimin e shpërndarjes së AD sipas Microsoft?

(1 pikë)

A) caktimi i numrit të domain-eve të kërkuar

B) caktimi i numrit të DC të kërkuar

C) caktimi i numrit të strukturave forest të kërkuar

D) caktimi i pozicionit të DC

Përgjigje: C

17. Rrethoni përgjigjen e saktë. Çfarë lloj grupi mund të mbajë një grup lokal në rastin kur duhet të vendosim grupet brenda njëra-tjetrës?

(1 pikë)

A) grup global

B) grup domain local

C) grup universal

D) grup lokal të makinës

Përgjigje: A

18. Rrethoni përgjigjen e saktë. Sa është minimumi i DC (domain controllers) që duhet të ketë një domain, pavarësisht masës së tij (domain-it)?

(1 pikë)

A) 1

B) 2

C) 3

D) 4

Përgjigje: B

19. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cili mjet përdoret për të menaxhuar administrime të deleguara?

(1 pikë)

- A) Active Directory Domain
- B) Menaxhimi i kompjuterit
- C) Shërbimet në Active Directory
- D) Përdoruesit dhe kompjuterat e Active Directory

Përgjigje: D

20. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila është mënyra e fundit e tentuar për rezolucionin e emrit të hostit para se klienti Windows Klient të dorëzohet dhe të përgjigjet me mesazh gabimi duke treguar se emri i hostit nuk mund të zgjidhet?

(1 pikë)

- A) Broadcast i rrjetit
- B) Lmhost-e
- C) DNS server
- D) Host-e

Përgjigje: B

21. Rrethoni përgjigjen e saktë. Në cilin grup regjistrohen automatikisht të gjithë përdoruesit në domain?

(1 pikë)

- A) administratorë në domain
- B) të ftuar në domain (guest)
- C) përdorues të domain
- D) llogari në domain

Përgjigje: C

22. Rrethoni përgjigjen e saktë. Minimumi sa domain-e duhen të implementohen kur duam të konfigurojmë AD që suporton tri pozicione në WAN?

(1 pikë)

- A) 1
- B) 3
- C) 6
- D) 9

Përgjigje: A

23. Rrethoni përgjigjet e sakta. Një host po akseson një web server në një rrjet të largët. Cilët janë dy funksionet që kryhen nga pajisjet e rrjetit gjatë këtij bashkëbisedimi?

(2 pikë)

- A) rigjenerimi i sinjalit të të dhënave
- B) veprimi si klient apo si server
- C) aplikimi i opsioneve të sigurisë për të kontrolluar fluksin e të dhënave
- D) të shërbejë si destinacion burim për mesazhet

Përgjigje: A dhe C

24. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cila nga alternativat e mëposhtme siguron një ndërfaqës grafik për menaxhimin e politikave të grupeve?

(2 pikë)

- A) GPEDIT.MSC
- B) Windows Power Shell
- C) Windows Command Prompt
- D) GPMC

Përgjigje: A dhe D

25. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cili nga shërbimet e mëposhtme siguron disa nivele të aksesit në distance të server-ave?

(2 pikë)

- A) Windows Remote Management
- B) Volume Shadow Copy
- C) Remote Desktop Services
- D) Print Spooler

Përgjigje: A dhe C

26. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cilat janë dy arsyt kryesore për krijimin e një OU?

(2 pikë)

- A) zvogëlimi i trafikut të replikimit
- B) delegimet administrative
- C) aplikimi i Politikave të Grupit
- D) krijimi i një kufiri besueshmërie

Përgjigje: B dhe C

27. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cilat nga llojet e mëposhtme të serverave implementohen në shumicën e kompanive për të mbështetur veprimet dhe lidhjet e klientëve AD DS?

(2 pikë)

- A) DNS
- B) IIS
- C) SharePoint
- D) DHCP

Përgjigje: A dhe D

28. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cilat janë dy vendodhjet që mikrosfti përcakton për domain controller-at (DC-të)?

(2 pikë)

- A) anësore
- B) hub
- C) e brendshme
- D) satelit

Përgjigje: B dhe D

29. Rrethoni përgjigjet e sakta. Cilët janë dy llojet e site-ve që krijohen duke klikuar me të djathtën në kontejnerin e site-ve në IIS Manager?

(2 pikë)

- A) FTP
- B) SharePoint
- C) Joomla!
- D) Web

Përgjigje: A dhe D

30. Rrethoni përgjigjen e saktë. Rrjeti ka një domain Active Directory . Domain-i përmban 8 domain controller-a. Duhet të verifikoni që të gjithë domain controller-at mund të lidhen me serverin e orës. Cilën komandë duhet të ekzekutoni?

(1 pikë)

- A) netdom.exe query fsmo
- B) dcdiag.exe /e /test:Topology
- C) repadmin.exe /showrepl *
- D) dcdiag.exe /a

Përgjigje: D

31. Rrethoni përgjigjet e sakta. Rrjeti ka 50 DC me sistemin Windows Server 2008 R2. Ju duhet të krijoni një skript për risetimin e fjalëkalimit të DSRM (Directory Services Mode) në të gjitha DC-të. Cilat janë procedurat për zgjidhjen e problemit?

(2 pikë)

- A) Active Directory e Përdoruesve dhe Komputerve
- B) Ntdsutil
- C) Dsmain
- D) Përdoruesit Lokal dhe Groupet

Përgjigje: BD

32. Vlerësoni shprehjet e mëposhtme me V (e vërtetë) dhe G (e gabuar):

(3 pikë)

- A) Vetëm Microsoft siguron shërbime që ekzekutohen në sistemet operative Windows Server? ____
- B) Windows Server 2008 R2 suporton vetëm IPv4. ____
- C) Kur ju refuzoni një kërkesë, ajo kërkesë nuk mund të plotësohet nga asnjë prej grupit të pjesëtarëve. ____

Përgjigje: A - V; B - G; C - V

33. Vlerësoni shprehjet e mëposhtme me V (e vërtetë) dhe G (e gabuar):

(3 pikë)

- A) Një server database dhe një databazë janë e njëjta gjë. ____
- B) Një drajver i pa caktuar është gjithmonë po aq i sigurt sa një drajver i caktuar. ____
- C) Grupet lokale të makinës mund të përmbajnë llogari dhe grupe nga çdo domain në forest. ____

Përgjigje: A - G; B - G; C - V

34. Vlerësoni shprehjet e mëposhtme me V (e vërtetë) dhe G (e gabuar):

(3 pikë)

A) Në një forest të vetëm në AD ka skema të shumëfishta. ____

B) Mund të krijoni Politika të Grupeve dhe t'i lidhni me kontejnera të shumëfishtë.

C) Me qenë se AD nuk ka kontejnera për të ruajtur llogaritë e përdoruesve dhe grupeve duhet të krijoni njësi organizative për t'i mbajtur ato. ____

Përgjigje: A - G; B - V; C - G

35. Cilat janë karakteristikat për shërbimin e web-it? Listojini ato më poshtë:

(3 pikë)

1. ____

2. ____

3. ____

Përgjigje:

1. Lidhje jo të forta

2. I zgjerueshëm

3. Ndërveprues

36. Çfarë duhet të aktivizoni që t'i lejonin një Windows server të shpërndajë detyra printimi në printera të shumfishtë nga një radhë printimi?

(1 pikë)

Përgjigje: Printer pooling.

37. Përkufizoni çfarë është roli i një server në rrjet:

(1 pikë)

Përgjigje: Roli i një server është një koleksion përgjegjësish që i sigurohet rrjetit ose shërbimeve të rrjetit.

38. Shpjegoni cili është funksioni i **butonit Session** tek kutia dialoguese e rekuiziteve të përdoruesit:

(2 pikë)

Përgjigje: Butoni Session lejon konfigurimin e kohës së fillimit dhe përfundimit të komunikimit të një përdoruesi. Është minimumi i kërkuar në konfigurimin e të drejtave të llogarisë së një përdoruesi lokal.

39. Cili është kufiri i besueshmërisë në rrjetet e Active Directory dhe pse? Jepni shpjegimin tuaj:

(2 pikë)

Përgjigje:

Struktura forest. Forest është kufiri i besueshmërisë sepse të gjithë domain-et në forest besojnë të gjithë domain-et përmes disa rrugëve të besueshme kalimi (transitive trust path).

40. Jepni përkufizimin e një **forest-i të besueshëm** dhe **një forest-i burim**:

(2 pikë)

Përgjigje:

- Një *forest i besueshëm* nënkupton një marrëdhënie mes strukturave forest. Besueshmëria mund të jetë e njëanëshme ose e dyanëshme.
- Një *forest në Active Directory (burim)* përdoret për të mbledhur apo shpërndarë burimet e nevojshme nga të gjithë apo disa përdorues në rrjet.

41. Cili parim sigurie përcakton se një sistem duhet të ketë jo më shumë akses sesa kërkohen për të kryer qëllimin e tij primar dhe pse?

(3 pikë)

Përgjigje:

Least privilege. Parimi i privilegjit të fundit thekson se përdoruesit dhe sistemet nuk duhet të kenë më shumë akses se sa u nevojitet për të kryer detyrat e tyre. Ky parim përcakton se sistemi mund të bëjë vetëm atë për çfarë është adresuar dhe asgjë më shumë. Ky parim është i vlefshëm për të siguruar veprimet e rrjetit.

42. Përcaktoni një objekt të politikave të grupeve (GPO), një preferencë të politikave të grupeve (Define Group Policy Preferences), si dhe cili është ndryshimi midis tyre:

(3 pikë)

Përgjigje:

- Objekti i politikave të grupeve (GPO) është një koleksion opsionesh që aplikohen në kompjuterat Windows duke i lidhur ato tek një kontejner brenda strukturës së AD-së.
- Tek preferencat bën pjesë ndërfaqësi grafik. Një mënyrë më e thjeshtë për të konfiguruar opsionet.
- Ndryshe nga politikat, preferencat mund të ndryshohen nga përdoruesit.

43. Cilët janë **dy** prej llojeve të serverave Monitorues Microsoft?

(2 pikë)

Përgjigje:

SCOM, SCVMM, dhe DPM.

44. Përkufizoni çfarë është një strukturë **tree** (pemë) në domain?

(2 pikë)

Përgjigje:

Një **tree** është një grup hierarkik domain-esh që kanë një emërtim bazë të përbashkët.

45. Përkufizoni çfarë është një **mail server** dhe një **server bashkëpunimi** (collaboration server):

(2 pikë)

Përgjigje:

- *Një mail server* dërgon dhe merr mesazhe e-mail-i për llogari të përdoruesve dhe i ruan mesazhet në kutinë e mesazheve të tij.
- *Një server bashkëpunimi* siguron shërbime bashkëpunimi siç është një mesazh i çastit (IM), kalendari, dokumentet e përbashkëta (File&Folder) dhe procesi i fluksit të punës.

46. Cili është ndryshimi mes **lejeve të veçanta** dhe atyre **standard** NTFS? Jepni një shembull:

(3 pikë)

Përgjigje:

Lejet e veçanta NTFS janë më shumë grimca lelesh që përbëjnë lejet standard NTFS.

Për shembull, leja **standard Lexo**, ka në përbërje Leje të veçanta: Të Dhënat e lexueshme, Tiparet e Leximit, Tiparet e Zgjeruara të Leximit, të drejtat dhe Leja Speciale e Leximit.

47. Përkufizoni shërbimin përgjues (të sigurisë) IIS, cili është protokoli përkatës i tij dhe përse përdoret.

(3 pikë)

Përgjigje:

- IIS është një shërbim që merr kërkesat hyrëse dhe dërgon përgjigje tek këto kërkesa Brenda Shërbimit Informativ të Internetit.
- Protokoli kryesor përgjues është HTTP.sys.
- Ai përdoret për kërkesat dhe përgjigjet standard të faqeve web.
-

48. Përgjithësisht roli i DFS nuk vihet re, si e instalojmë atë?

(2 pikë)

Përgjigje:

DFS (Distributed File System) instalohet duke shtuar Shërbimin e Rolit të DFS-së tek roli i Dosjes së Shërbimeve tek Server Manager.

49. Shpjegoni çfarë është **FTP anonime**?

(2 pikë)

Përgjigje:

FTP anonime është një mënyrë për të siguruar aksesin e përdoruesit tek dosjet në serverat publik. Përdoruesit e lejuar tek të dhënat e këtyre server-ave nuk kanë nevojë të identifikohen, por të logohen si përdorues anonim.

50. Përkufizoni **hapësirën e emrit DFS**:

(3 pikë)

Përgjigje:

Hapësira e emrit DFS është një hapësirë emri e thjeshtë e cila përfaqëson një grup skedarësh, të cilët shpërndahen nëpër server të shumëfishtë, të grupuar së bashku në një skedar të vetëm virtual në server.

51. Një kompani po implementon IPv6. Momentalisht përdor edhe DNS edhe WINS për rezolucionin e emrit. WINS përdoret vetëm me IPv4. Shpjegoni çfarë duhet të bëjë kompania që të përdorë llojin e emrave NetBIOS për IPv6?

(3 pikë)

Përgjigje:

Duhet të përdorë opsionin e ri të Microsoft, Global Names. Kur aktivizohet, në serverin DNS mund të krijohet manualisht një regjistrim me një emër të vetëm. Këto regjistrime kombinohen me emrin burim të NetBIOS, sikurse çelësi i serverit.

52. Çfarë janë proxy server-at dhe si i mbrojnë ato rrjetat kompjuterike?

(3 pikë)

Përgjigje:

- *Proxy server-at* kryesisht parandalojnë përdoruesit e jashtëm para se të identifikojnë adresën e brendshme IP të rrjetit. Pa një adresë IP të saktë, as pozicioni fizik i rrjetit nuk mund të identifikohet. (2 pikë)
- *Proxy server-at* mund ta bëjnë një rrjet virtualisht të padukshëm për përdoruesit e jashtëm. (1 pikë)

53. Kompania juaj ka një forest në Active Directoryt. Çdo zyrë rajonale ka një njësi organizative (OU) të emërtuar Marketing. Njësia organizative e Marketing-ut mban të gjithë përdoruesit dhe kompjuterat brenda departamentit Marketing. Duhet të instalohet Microsoft Office 2007 vetëm tek këta kompjutera. Krijohet një GPO e emërtuar MarketingApps. Çfarë veprimesh duhen bërë më tej?

(2 pikë)

Përgjigje:

- Konfigurohet GPO për të caktuar aplikacionin tek llogaria e kompjuterit.
- Lidhet GPO tek secila Njësi Organizative e Marketing.

54. Ju krijoni një zonë primare standard për test.com. Duhet të specifikoni një emër përdoruesi Admin1 si personi përgjegjës për menaxhimin e zonës. Çfarë veprimesh duhet të bëni?

(3 pikë)

Përgjigje:

Hapim dosjen %Systemroot\System32\DNS\Test.com.dns duke përdorur Notepad. Ndryshojmë të gjitha emërtimet për "hostmaster.test.com" tek "admin1.test.com". Nga DNS Manager, hapim opsionet e regjistrimeve Start of Authority (SOA) të test.com. Përcaktojmë admin1.test.com si personi përgjegjës.

55. Cilat janë **dy** mënyrat e vlefshme për të fshirë/çinstaluar rolin AD DS?

(2 pikë)

Përgjigje:

- Ekzekutojmë Dcpromo dhe zgjedhim opsionin Remove.
- Shkojmë në Server Manager, Roles dhe çinstalojmë rolin AD DS.

56. Në një rrjet me 2 server-a dhe 20 **workstations (poste pune)**, ku është vendi më i mirë për të instaluar një program antivirus? Jepni shpjegimin tuaj pse:

(2 pikë)

Përgjigje:

Një program anti-virus duhet të instalohet tek të gjithë server-at dhe workstation për të siguruar mbrojtje. Pasi përdoruesi individual mund të hynë në çdo workstation dhe të fusë një virus duke lidhur një hard-disk të jashtëm apo një USB.

57. Cili është ndryshimi mes një **domain-i** dhe një **zone**?

(3 pikë)

Përgjigje:

Meqënëse zonat përdorin emra domain-esh, është e lehtë të gabosh. Zona mban regjistrimet aktuale për një pjesë të emrit të domain-it. Një domain si p.sh. test.com ka regjistrime të shpërndara nëpër disa zona. Server i bazës së emrit ruan pjesën “.” që zakonisht fshihet nga përdoruesit në fund të emrit të domain-it.

58. Cili është roli primar i **serverit DHCP**?

(2 pikë)

Përgjigje:

Serveri DHCP cakton automatikisht adresë IP dhe konfigurime të tjera IP në një rrjet.

59. Një zyrë ka 10 përdorues. A duhet vendosur një server GC (Global Catalog) në këtë vend dhe pse?

(2 pikë)

Përgjigje:

Nuk është e nevojshme. Microsoft rekomandon që të përdoret katalogu global për 50 ose më shumë përdorues në një zyrë.

60. Cili është ndryshimi mes caktimit të Share Permissions tek “Të Gjithë” me kontroll të plotë dhe Authenticated Users me kontroll të plotë?

(2 pikë)

Përgjigje:

“Të Gjithë” siç e tregon dhe emri, përfshin “të gjithë”, si llogaritë guest dhe sesionet kompjuter-në-kompjuter (null session).

Grupi “Authenticated Users” është më i sigurt pasi i përjashton këto grupe duke përfshirë vetëm përdoruesit në domain.

61. Kompania jonë nuk dëshiron të lidhet në internet. Ne po përdorim Windows Server 2008 dhe Windows Vista DNS i cili është thelbësor për rezolucionin e emrit. Dimë se DNS-ja është e ndërtuar të punojë me internet. Çfarë mund të bëjmë, jepni shpjegimin tuaj?

(4 pikë)

Përgjigje:

Pavarësisht se fillimisht DNS-ja u ndërtua për të punuar me internet, nuk ka problem edhe nëse përdoret privatisht. Në fakt, nëse kemi një domain Active Directory, ai do të duhet. Në këtë rast do krijojmë dhe konfigurojmë një mjedis të ndarë DNS që është shumë i ngjashëm me internetin. Në këtë rast ne do kontrollojmë të gjitha nivelet dhe jo vetëm një pjesë të vogël.

62. Cilat janë **tri** prej problemeve më të zakonshme me softwar-in që mund të çojnë në defekte të rrjetit?

(3 pikë)

1. _____
2. _____
3. _____

Përgjigje:

1. Probleme me komunikimin klient - server
2. Konflikt mes aplikacioneve
3. Gabim në konfigurim
4. Ngatërresa të protokolleve
5. Çështjet e sigurisë
6. Politikat e përdoruesve dhe të drejtat e caktuara

63. Rrjeti juaj ka vetëm një domain AD. Zyra juaj kryesore ka lidhje në internet. Zyra e degës tuaj do lidhet me zyrën kryesore përmes rrjetit WAN. Lidhja në WAN do krijojë gjerësi bande të limituar dhe nuk do ketë akses në internet. Zyra e degës do ketë 30 servera Windows Server 2008 R2. Duhet të planifikoni shpërndarjen në zyrën e degës. Shpërndarja duhet të plotësojë këto kusht:

- Instalimi automatic.
- Kompjuterat të aktivizohen automatikisht.
- Trafiku i rrjetit mes dy zyrave të minimizohet.

Si duhet ta realizoni këtë?

(3 pikë)

Përgjigje:

Në zyrën e degës duhet:

- Të implementohet KMS (Key Management Service)
- Një server DHCP
- Një sistem WDS (Windows Deployment Services)

64. Një kompani ka një zyrë qendrore dhe dy degë. Çdo zyrë ka një domain controller dhe një file server. Rrjeti konsiston në një domain Active Directory të vetëm dhe përdor sistemin Windows Server 2008 R2. Duhet planifikuar shpërndarja e Distributed File System (DFS) që të plotësohen këto kërkesa:

- Të sigurohet që përdoruesit të shohin vetëm skedarët tek të cilët kanë akses.
- Të sigurohet që përdoruesit të aksesojnë të dhënat lokalisht.
- Të minimizohet gjërësia e kërkuar e bandës për replikimin e të dhënave.

Si duhet vepruar në këtë rast?

(3 pikë)

Përgjigje:

- Bëhet shpërndarja e hapësirës së emri DFS vetëm për skedarët e caktuar.
- Aktivizohet një renditje e bazuar në akses.
- Përdoret një replikim DFS.

65. Rrjeti ynë ka disa Windows Server 2008 R2 që po ekzekutojnë Windows Server Update Services (WSUS). Serverat WSUS shpërndajnë përditësime tek të gjithë kompjuterat në rrjetin e brendshëm. Përdoruesit në distancë lidhen nga kompjuterat e tyre në rrjetin e brendshëm duke përdorur lidhjen splittunnel VPN. Duhet një strategji për të dërguar përditësime tek përdoruesit në distancë. Kjo strategji duhet të plotësojë këto kushte:

- Të minimizohet përdorimi i gjerësisë së bandës në lidhjet VPN.
- Përditësimet të aprovohen nga WSUS para se të instalohen në kompjuterat klient.

Si duhet zbatuar kjo?

(3 pikë)

Përgjigje:

- Shpërndahet një server WSUS shtesë.
- Konfigurohen përdoruesit në distancë të përdorin serverin WSUS shtesë.
- Konfigurohet server WSUS shtesë që t'i lejë të aktivizuar përditësimet në faqen e Microsoft.

66. Shpjegoni rolin dhe funksionin e Mail Server-it MDaemon.

(4 pikë)

Përgjigje:

Serveri i mesazheve MDaemon suporton protokollat IMAP, SMTP dhe POP. Ofron performancë të qëndrueshme në sajë të aplikacioneve të tij të shumtë dhe dizajnit user-friendly (miqësor). Ky server email-i është ndërtuar për t'u ardhur në ndihmë bizneseve të mesme dhe të vogla. MDaemon është i vleftshëm në gjuhë të ndryshme dhe mban lista email-esh, filtra të përmbajtjes, domain-e të shumëfishta, por dhe fleksibilitet në administrim.

67. Listoni **tri** prej shërbimeve kryesore që ofron MDaemon për klientët e tij:

(3 pikë)

1. _____
2. _____
3. _____

Përgjigje:

1. WorldClient (Web-Based Email)
2. MDaemon Remote Administration
3. WorldClient Instant Messenger
4. Microsoft Outlook Integration (Outlook Connector)

68. Çfarë është WorldClient, çfarë roli ka ai në komunikim dhe ku përdoret?

(5 pikë)

Përgjigje:

WorldClient është Email-i i klientit MDAemon i bazuar në përdorimin e Web-it. Siguron akses të lehtë në inbox, kalendar, kontakte, detyra, shënime, dhe dokumente nga zyra, shtëpia apo çdo vend tjetër ku ka akses në internet. Përditësimi automatik i opsioneve të tij e bën shumë të lehtë në mirëmbajtje. I ofruar falas me serverin e mesazheve [MDaemon](#), WorldClient dërgon dhe merr mesazhe nga çdo kompjuter i lidhur, smartphone, apo tablet që përdor një browser internet. Përdoret në kompjutera me sisteme shfrytëzimi Windows, Mac OS X, and Linux dhe suporton lidhjet SSL.

69. Duhet të përcaktoj një server DNS totalisht privat për rrjetin e kompanisë time. Si mund të konfigurohen të dhënat rrënjësore (root hint)?

(3 pikë)

Përgjigje:

Kur të dhënat rrënjësore nuk duhet të jenë të lidhura me serverin e emrit rrënjë të internetit, zakonisht duhet të synojnë drejt niveleve më të larta të DNS-së së kompanisë. Në fakt root hints janë ndërtuar të shkojnë drejt çfarëdo niveli të lartë të çdo lloji hierarkie DNS që përdoret.

70. Shpjegoni si mund të ndryshohet adresimi (site) i një server në një tjetër?

(5 pikë)

- Varianti i ri i WFAS ka një numër komponentësh të avancuar që ndihmojnë në përmirësimin e sigurisë.
- Përshtatet shumë mirë me ndërfaqësin e ri dhe me IPSec (Sigurimin e IP-së).
- Ka filtra dy-drejtimesh ndryshe nga version i vjetër, duke filtruar kështu edhe informacionin hyrës dhe atë dalës.
- Me rregullat e reja të përmirësuara mund të krijohen rregulla në firewall për shërbimet e SD-së, llogarive dhe grupeve.

72. Vihet re një rritje e sasisë së trafikut mes zyrës kryesore të një kompanie dhe zyrës së saj në një degë. Kohët e fundit është shtuar një server Global Catalog/Domain controller në zyrën e degës. Shpjegoni pse është krijuar gjithë ky grumbullim trafiku?
(4 pikë)

Përgjigje:

Me sa duket nuk është krijuar një adresim për secilin pozicion. Katalogët Global kur pozicionohen në adresim, ndihmojnë në kontrollin e replikimit dhe ndërpresin përdorimin e bandës (kanaleve) të komunikimit. Të dhënat ngjeshen para se të dërgohen në adresim, gjë që e mban përdorimin e gjerësisë së bandës në vlera të ulëta.

73. Të gjithë bizneset i përkasin një grupi global të quajtur Shitës. Vendosen tri file server-a në një njësi të re organizative (OU) të quajtur File Servers Konfidencial. Këta File Server-a mbajnë të dhëna të rezervuara. Duhet të regjistrohen të gjitha përpjekjet e dështuara për të hyrë në të dhënat konfidenciale. Cilat janë veprimet që duhet të bëjmë?

(5 pikë)

Përgjigje:

- Krijohet një objekt i ri tek Politikat e Grupeve (GPO) dhe lidhet me CONFIDENTIALFILESERVERS OU. Konfigurohet objekti i kontrollit për hyrje të pasuksesshme dhe rregullat e politikave të aksesit. 3 pikë)
- Në secilin skedar të tri file server-ve shtohet grupi global Shitës me butonin **Auditing**. Konfigurohet opsioni i kontrollit **Failed Full** tek kutia dialoguese **AuditingEntry**. (2 pikë)

74. Në një rrjet ndodhet një domain AD me emrin test.com. Duhet shkruar një script që ekzekuton Best Practices Analyzer (BPA) çdo javë për të gjithë rolet e serverit që

suporton BPA në secilin domain controller. Duhet arritur kjo me minimumin e përpjekjeve administrative. Si mund ta realizojmë këtë process?

(3 pikë)

1. _____
2. _____
3. _____

Përgjigje:

- Importohen modulet e rasteve më të mira praktike.
- Merret modeli BPAI/Thërritet modeli BPA.
- Merren rezultatet BPA.

75. A rriten nivelet funksionale në domain dhe forest? Nëse rriten çfarë problemi paraqitet?

(4 pikë)

Përgjigje:

Jo nuk duhen rritur. Nivelet funksionale kur rriten një herë nuk mund të ulen sërish. Në disa raste rekomandohet të anashkalohet një nivel, në vend që të rritet. Në këtë rast aktivitetet e njohura të ardhshme në restaurim dhe upgrade duhen marrë parasysh para rritjes së nivelit funksional.

76. Duam të përdorim zonat e integruara të Active Directory për serverin tonë DNS, por gjithashtu duam të krijojmë kopje të dyta të zonës në një server jo-Microsoft. A është e mundur kjo dhe pse?

(4 pikë)

Përgjigje:

Po, por nuk do të jetë një kopje e gjallë/e replikueshme e zonës. Në këtë rast, ne mund të krijojmë vetëm kopje të dytë të zonës DNS. Kjo do të thotë se klientët DNS të këtij serveri jo-Mikrosoft do të kenë aftësinë të zgjedhin regjistrimet, por zona nuk mund të përditësohet as manualisht e as automatikisht.

77. Çfarë roli kanë Objektet tek Politikat e Grupeve?

(1 pikë)

Përgjigje:

Objektet janë një grup elementesh që përcaktojnë paraqitjen e një sistemi dhe sjelljen e tij për një grup përdoruesish.

78. Çfarë funksioni ka sistemi Fault Tolerance? Si e kryen ai funksionin që ka?A e realizon këtë funksion në çdo rast?

(3 pikë)

Përgjigje:

- Një system "fault tolerance" (tolerues ndaj gabimeve) siguron vlefshmërinë e vazhdueshme të të dhënave.
- Ai e kryen detyrën e vet duke eliminuar pikën kyçe të gabimit (dështimit).
- Ky lloj sistemi nuk është në gjendje të mbrojë të dhënat në disa raste si p.sh fshirja aksidentale e të dhënave.

79. Çfarë është një NOS? Shkruani emërtimin e plotë dhe shpjegoni funksionin:

(3 pikë)

Përgjigje:

NOS - Network Operating System - Nos është një program special, detyra kryesore e të cilit është sigurimi i lidhjes në rrjet i një kompjuteri, në mënyrë që ai të mund të komunikojë me kompjuterat e tjerë dhe pajisjet e rrjetit.

80. Kompania juaj ka një Active Directory forest që punon në nivelin funksional të Windows Server 2008. Implementoni të drejtat ADRMS. Ju instaloni Microsoft SQL Server 2005, por kur tentoni të hapni faqen web të administrimit të ADRMS merrni mesazhin e gabimit "SQL Server-i nuk ekziston ose aksesimi është refuzuar".

1. Jepni emërtimin gjatë të akronimit AD RMS.
2. Listoni hapat që ndiqni për të zgjidhur problemin

(3 pikë)

Përgjigje:

1. Active Directory Rights Management Services
2. - Ristartoni IIS.
- Startoni shërbimin the MSSQLSVC.

81. Kompania ka një domain Active Directory. Një përdorues tenton të logohet në një kompjuter të fikur prej 12 javësh. Administrator merr një mesazh gabimi që identifikimi ka dështuar. Duhet të siguroheni që përdoruesi të mund të logohet në kompjuter. Çfarë duhet të bëni?

(3 pikë)

1. _____
2. _____
3. _____

Përgjigje:

1. T'i bëjmë reset llogarisë së kompjuterit.
2. Të shkëpusim lidhjen e kompjuterit me domain-in.
3. Të rilidhim kompjuterin në domain-in.

82. Rrjeti ynë ka një domain AD. Domain-i ka çertifikatë autoriteti (CA). Rrjeti ka disa switch-e të shtresës së 3. Duhet të sigurohemi që switch-et e marrin këtë çertifikatë nga CA.

- Shpjegoni kuptimin e çertifikatës së autoritetit.
- Tregoni rastet kur përdoret ajo.
- Jepni zgjidhje për situatën konkrete.

(3 pikë)

Përgjigje:

- Çertifikata e autoritetit i jep mbajtësit të saj një nivel besueshmërie dhe i siguron të tjerët për vërtetësinë dhe sigurinë e domain-it në rastin konkret.

- Një përdorim tipik i kësaj çertifikate është vërtetimi i nivelit të sigurisë tek protokoli HTTPS por përdoret edhe nga qeveritë për firmën elektronike të dokumenteve.
- Për kompaninë duhet vendosur në server roli Network Device Enrollment Service.

BANKË ME NJËSI TESTESH

PROFILI:
LËNDA:

RRJETE TË DHËNASH
“Baza të dhënash”, klasa 13-të

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. SQL është shkurtim për:

(1 pikë)

- A) Structure Query Language
- B) Strong Question Language
- C) Stuctured Question Language
- D) Sotware Query Language

Përgjigje: A

2. Rrethoni përgjigjen e saktë. Nëse në një query nuk vendoset instruksioni WHERE, në rezultat marrim:

(1 pikë)

- A) të gjithë rreshtat
- B) të gjithë atributet
- C) të gjithë tabelat
- D) të gjithë qelizat

Përgjigje: B

3. Rrethoni përgjigjen e saktë. Kur operatori LIKE përdoret për të zgjedhur një bashkësi rreshtash në një query SQL, simboli % përcakton:

(1 pikë)

- A) një string të çfarëdoshëm
- B) një karakter të çfarëdoshëm
- C) një rresht të çfarëdoshëm
- D) një kusht të përcaktuar

Përgjigje: B

4. Rrethoni përgjigjen e saktë. Operatori BETWEEN në SQL:

(1 pikë)

- A) specifikon që një tabelë është një çelës primar
- B) specifikon se nga cilat tabela po për zgjedhim të dhëna
- C) specifikon një rang vlerash për të testuar
- D) tregon një operator krahasues të vlerave në tabelë

Përgjigje: C

5. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga shprehjet SQL, përdoret për të kthyer numrin rekordeve në tabelën “Persons”?

(1 pikë)

- A) SELECT COUNT() FROM Persons
- B) SELECT COUNT(*) FROM Persons
- C) SELECT COLUMNS() FROM Persons

D) SELECT COLUMNS(*) FROM Persons

Përgjigje: B

6. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga shprehjet SQL, përdoret për të kthyer vlera të ndryshme të rreshtave?

(1 pikë)

A) SELECT DIFFERENT

B) SELECT UNIQUE

C) SELECT DISTINCT

D) SELECT UNION

Përgjigje: C

7. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga shprehjet SQL, përdoret për të renditur rezultatet në bashkësi?

(1 pikë)

A) SORT

B) ORDER

C) ORDER BY

D) SORT

Përgjigje: C

8. Rrethoni përgjigjen e saktë. Duke përdorur SQL, si mund të fshihen rekordet në tabelën "Persons", ku "FirstName" është "Peter".

(1 pikë)

A) DELETE FirstName='Peter' FROM Persons

B) DELETE ROW FirstName="Peter" FROM Persons

C) DELETE FROM Persons WHERE FirstName = "Peter"

D) DELETE FirstName FROM Persons WHERE FirstName = "Peter" and emër table name = "Persons"

Përgjigje: D

9. Rrethoni përgjigjen e saktë. Fjala kyçe IN në SQL përcakton:

(1 pikë)

A) tabelat nga të cilat po zgjedhim ose po fshijmë të dhëna

B) nëse një vlerë është një nga vlerat e një liste vlerash ose një sub-query

C) fjalën kyçe DISTINCT në SQL

D) një vlerë e cila nuk përfshihet në listen e vlerave të një sub-query

Përgjigje: B

10. Rrethoni përgjigjen e saktë. Rreshtat e tabelës njihen edhe si:

(1 pikë)

A) attribute

B) rekorde

C) fusha

D) qeliza

Përgjigje: B

11. Rrethoni përgjigjen e saktë. Fjala kyçe JOIN në SQL përdoret për të:

(1 pikë)

- A) update-uar një tabelë të databazës
- B) verifikuar që të dhënat e futura janë të sakta
- C) zgjedhur të dhëna nga dy ose më shumë tabela që lidhen nga attribute të përbashkëta
- D) shtuar një apo disa të dhëna në një tabelë të databazës

Përgjigje: C

12. Rrethoni përgjigjen e saktë. Cila nga shprehjet SQL, selekton numrin total të porosive në tabelën 'Shitjet':

(1 pikë)

Nr-Porosi	Datë	ID-Klienti
01	27.03.2017	013
02	13.04.2017	014

- A) SELECT AVG (NrPorosi) FROM Shitjet
- B) SELECT SUM (NrPorosi) FROM Shitjet
- C) SELECT COUNT (NrPorosi) FROM Shitjet
- D) SELECT MAX (NrPorosi ,Datë, ID-Klienti) FROM Shitjet

Përgjigje: C

13. Rrethoni përgjigjen e saktë. Çfarë është një çelës i jashtëm?

(1 pikë)

- A) Çelës në një tabelë database, e cila lidh tabelën me një tabelë tjetër, ku ky çelës është çelës primar.
- B) Kolonë që mund të ketë vlera NULL.
- C) Mekanizëm kyçje në SQL.
- D) Atribut i një tabele në database, që përcakton një kriter kërkimi.

Përgjigje: A

14. Rrethoni përgjigjen e saktë. Kur fusim të dhëna në një tabelë, duhet të përcaktojmë një listë me të gjithë emrat e kolonave?

(1 pikë)

- A) Po
- B) Jo

Përgjigje: A

15. Shpjegoni çfarë paraqet query:

SELECT * FROM Persons

(1 pikë)

Përgjigje: Afishon të gjitha atributet nga tabela Persons.

16. Jepni përkufizimin e sistemeve **RDBMS** dhe **OODBMS**.

(2 pikë)

Përgjigje:

- **RDBMS** (Relational database management system) është sistemi i menaxhimit të një database relacionale, përdor gjuhën SQL në stukturimin e të dhënave.
- **OODBMS** (Object oriented database management system) është sistemi i menaxhimit të një Database mbështetur mbi gjuhët e programimit të orientuara mbi objekte.

17. Përkufizoni çfarë është një bazë të dhënash:

(2 pikë)

Përgjigje: Një bazë të dhënash është një depozitë, e cila ruan të dhëna të organizuara dhe të strukturuara në formë tabele.

18. Shpjegoni strukturën e një qyery në database.

(3 pikë)

Përgjigje: Një qyery është një strukturë e përbërë nga tri operatorë kryesorë:

- **SELECT** (liston atributet të cilat duam të afishojmë).
- **FROM** (tregon emrin e tabelës nga të cilat janë përzgjedhur atributet).
- **WHERE** (tregon një kusht të caktuar).

19. Shpjegoni funksionin e gjuhës SQL.

(2 pikë)

Përgjigje: SQL qëndron për Structured query language, është gjuhë pyetëse dhe gjuha e strukturimit të të dhënave në DATABASE, përbëhet nga operatorët bazë SELECT, FROM, WHERE.

20. Tregoni funksionin e operatorëve logjikë AND dhe OR në SQL.

(2 pikë)

Përgjigje:

- Operatori **AND** (dhe) deklarohet në pjesën WHERE të një qyery, përdoret për të përfshirë dy ose më shumë kushte.
- Operatori **OR** (edhe) deklarohet në pjesën WHERE të një qyery, pranon ose njërin kushtë të deklaruar ose kushtin tjetër, jo të gjitha konditat.

21. Shpjegoni çfarë është: entiteti, atributi, relacioni.


(3 pikë)

Përgjigje:

- **Entiteti** është një tabelë e cila i referohet modelit relational të ruajtjes së të dhënave.
- **Atributi** është një karakteristikë apo cilësi që përshkruan një entitet të caktuar.
- **Relacioni** është një lidhje midis dy apo më shumë entiteteve.

22. Tregoni paraqitjen skematike të një entiteti, atributi dhe relacioni në skemën ERD:

(3 pikë)



23. Listoni më poshtë tipet e lidhjeve në bazën e të dhënave relacionale.

(3 pikë)

1. _____
2. _____
3. _____

Përgjigje:

Tri tipet kryesore të lidhjeve në bazën e të dhënave janë:

1. Unare
2. Binare
3. Ternare

24. Listoni më poshtë nivelet e arkitekturës me tri skema:

(3 pikë)

1. _____
2. _____
3. _____

Përgjigje:

1. Niveli i brendshëm
2. Niveli konceptual
3. Niveli i jashtëm

25. Tregoni cilat janë karakteristikat e një baze të dhënash.

(3 pikë)

1. _____
2. _____
3. _____

Përgjigje:

1. Integriteti i të dhënave
2. Ndarja e të dhënave
3. Pavarësia e të dhënave

26. Përkufizoni çfarë është **pavarësinë logjike** dhe **pavarësinë fizike**, në një bazë të dhënash.

(2 pikë)

Përgjigje:

Pavarësia logjike e të dhënave është aftësia për të ndryshuar skemën konceptuale pa ndryshuar skemën e jashtme ose aplikacionet.

Pavarësia fizike e të dhënave është aftësia për të ndryshuar skemën e brendshme pa ndryshuar skemën konceptuale.

27. Shpjegoni arkitekturën me tri nivele në RDBMS.

(3 pikë)

1.

2.

3.

Përgjigje:

1. Niveli i brendshëm përshkruan strukturën e depozitimit fizik të bazës së të dhënave.
2. Niveli konceptual përshkruan strukturën e të gjithë databazës për komunitetin e përdoruesve.
3. Niveli i jashtëm përfshin skemat e jashtme ose pamjet e përdoruesve.

28. Cilët janë komponentët e mjedisit në një bazë të dhënash?

(5 pikë)

1.

2.

3.

4.

5.

6.

Përgjigje:

1. Grupi i përdoruesve
2. Sistemi i qeverisjes së bazës së të dhënave
3. Baza e të dhënave
4. Fjalori udhëzues i të dhënave
5. Ndërfaqja sistem/përdorues
6. Administrimi i Bazave të të Dhënave

29. Baza e të dhënave “**KURSET**”, përmban tabelat më poshtë:

Professor(ssn, profname, status, salary)

Course(crscode, crsname, credits)

Taught(crscode, semester, ssn)

Gjeni emrat e të gjithë profesoreve të cilët kanë dhënë mësim në kursin ‘CSC6710’.

(4 pikë)

Përgjigje:

SELECT profname

FROM professor join taught on

Professor .ssn =taught.ssn join course on

Taught.crscode= course .crscode

WHERE crscode= CSC6710 ;

30. Për tabelën e mëposhtme “**Notat**” ndërtoni shprehjen në DDL (Data Definition Language) për të krijuar atë:

(3 pikë)

IdStudent	Lënda	Nota
01	Matematikë	10
02	Letërsi	7

Përgjigje:

Create table Notat (

IDStudent int (), not null ;

IDLënda string, not null ;

Nota number, not null ;

);

31. Jepet tabela “Notat”, në bazën e të dhënave “Universiteti”, e cila mban notat e studentëve në lëndë të ndryshme: **Notat (IDStudent, IDLënda, nota)**

IDStudent	Lënda	Nota
01	Matematikë	10
02	Letërsi	7

Afishoni ID e Studentëve dhe notën maksimale nga tabela Notat:

(3 pikë)

Përgjigje:

SELECT IDStudent, MAX(nota)

From Notat

Group by IDStudent

32. Cilat janë veprimet bazë të një përdoruesi të autorizuar në një bazë të dhënash?

(3 pikë)

1. _____
2. _____
3. _____

Përgjigje:

Veprimet e një përdoruesi të autorizuar mbi një bazë të dhënash janë:

1. **Insert** (realizon veprimin e shtimit të një rekordi mbi një tabelë)
2. **Update** (realizon modifikimin e një rekordi të caktuar mbi një tabelë)
3. **Delete** (realizon fshirjen e një apo disa rekordeve në tabelë)